

RAPORT PËRMBLEDHËS

I AKTIVITETEVE TË PLATFORMËS CIVIKOS PËR VITIN 2018

Janar 2019

Përmbajtja

DONATORËT	3
LISTA E AKRONIMEVE.....	4
CIVIKOS GJATË 2018 – INFORMATA DHE FAKTE TË SHKURTËRA.....	5
BASHKËPUNIMI SHOQËRI CIVILE – QEVERI.....	5
Hartimi i Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2018-2022.....	5
Përzgjedhja e anëtarëve të shoqërisë civile në trupa të ndryshëm publik.....	6
Vlerësimi shtetëror rreth parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.....	7
Problemi i OJQ-ve me Bankat Komerciale	7
Grupet punuese të CiviKos - Pjesëmarrja në procesin e konsultimit publik.....	8
BASHKËPUNIMI PLATFORMA CIVIKOS - SHOQËRI CIVILE	9
Lansimi i fushatës “Pjesëmarrja Qytetare në Procesin e Politikë-Bërjes”	9
Publikimi i raportit të monitorimit “Konsultimi publik me organizata anëtare të CiviKos gjatë vitit 2017”	9
Trajnimet në kuadër të projektit TEAM të USAID.....	9
Trajnimet në kuadër të projektit “Drejt një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në hartimin e politikave” përkrahur nga Ambasada Holandeze në Kosovë	10
Punëtori rreth kontraktimit të shërbimeve për OSHC.....	10
Punëtori me Organizata të Shoqërisë Civile - Vlerësimi Shtetëror i Kosovës Rreth Parandalimit të Financimit të Terrorizmit dhe Shpërlarjes së Parave	11

PLATFORMA CIVIKOS

Platforma CiviKos është bashkim vullnetar i organizatave të shoqërisë civile, të përkushtuara për zhvillimin e një mjedisi të favorshëm për bashkëpunim midis shoqërisë civile dhe autoriteteve publike. Që nga themelimi i saj Platforma CiviKos ka qenë e angazhuar që të jetë zë i fuqishëm i organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, duke krijuar një ambient sa më të favorshëm të bashkëpunimit shoqëri civile - qeveri.

DONATORËT

CiviKos gjatë 2018 është mbështetur financiarisht nga:

- Projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim Kosovë (SCO-K), dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).
- Ambasada e Mbretërisë së Holandës- MATRA.
- Misioni i OSBE-së në Kosovë.
- UNDP zyra në Kosovë.
- TACSO zyra në Kosovë
- CiviKos është nën-kontraktorë i projektit të USAID Komunitat Transparente Efektive dhe Llogaridhënëse.

LISTA E AKRONIMEVE

CiviKos	Platforma CiviKos
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KCSF	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
KFOS	Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
GIZ	Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
ZQM/KM	Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit
ZKM	Zyra e Kryeministrit
Strategjia Qeveritare	Strategjia Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017
Këshilli	Këshilli për zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë civile.
TEAM	Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse

CIVIKOS GJATË 2018 – INFORMATA DHE FAKTE TË SHKURTËRA

- 235 organizata anëtare në CiviKos;
- Bordi i Platformës CiviKos gjatë vitit 2018 ka mbajtur 6 takime;

Gjatë vitit 2018 Sekretariati i Platformës CiviKos:

- Rregullisht ka dërguar buletin e javës tek organizatat anëtare me informata relevante për shoqëri civile si mundësi për grante, konferenca dhe informata tjera relevante;
- Ka angazhuar 3 praktikantë në periudha tre mujore;
- Trajnimet në kuadër të projektit të USAID TEAM kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2018 duke ngritur kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në nivel lokal me metodologji të avancuar mbi mësimin e aplikueshëm në realitet;
- Platforma CiviKos lehtëson punën e grupit punues për hartim të Strategjisë së re të bashkëpunimit shoqëri civile- qeveri 2019-2023;
- Janë organizuar 6 trajnime në kuadër të projekti “Drejt një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në hartimin e politikave” të përkrahur nga Ambasada Holandeze në Kosovë;
- Lansimi i fushatës “Pjesëmarrja Qytetare në Procesin e Politikë-Bërjes” në kuadër të projektit të financuar nga Ambasada Holandeze në Kosovë;
- CiviKos duke qenë pjesë e grupit punues për vlerësimin shtetëror për parandalim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ka avokuar që masat e propozuara që e ndikojnë punën e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë të jenë në linjë me parimet e përgjithshme të së drejtës për liri te asocimit, pa kufizime që eventualisht do të pengojnë punën e shoqërisë civile në Kosovë;
- CiviKos organizon punëtori rreth kontraktimit të shërbimeve për OSHC, së bashku me European Centre for Non Profit Law;
- CiviKos së bashku me ZQM/Zyra e Kryeministrit kanë organizuar takime rajonale për të diskutuar rreth Strategjisë së re të bashkëpunimit shoqëri civile-qeveri 2019-2023.

BASHKËPUNIMI SHOQËRI CIVILE – QEVERI

Hartimi i Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2018-2022

- Në zyret e ZQM më 23 Prill 2018, është mbajtur takimi i parë i grupit punues për hartimin e koncept dokumentit për vullnetarizëm.
- CiviKos në bashkëpunim me ZQM, në Maj 2018 ka hapur thirrjen për anëtarë të rinj të shoqërisë civile për të qenë pjesë e grupit punues për hartim te Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023.

Përzgjedhja e anëtarëve të shoqërisë civile në Këshillit për Bashkëpunim shoqëri civile-qeveri

- Për të siguruar përfaqësim dhe diversitet, thirrja për anëtarë të grupit punues për hartim të Strategjisë ka qenë e hapur për përfaqësues të organizatave dhe rrjeteve sektoriale.

Pas mbylljes së afatit të gjithë ata që kanë aplikuar janë përzgjedhur.

Kandidatët e përzgjedhur janë:

- ✓ Ekrem Bajrami, nominuar nga IKC;
- ✓ Shukrije Gashi, nominuar nga Coalition for Social Justice;
- ✓ Petrit Tahiri, nominuar nga KOMF ;
- ✓ Isuf Zejna, nominuar nga Pro-Open ;
- ✓ Nora Zhilivoda, nominuar nga KAMA ;
- ✓ Arben Sejdej, nominuar nga ECMI Kosovo.

ZQM në bashkëpunim me CiviKos më 14 Qershor 2018, në Villa Germia kanë organizuar punëtorinë e radhës me grupin punues për hartim të Strategjisë së re për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023.

Pas vendosjes së kornizave të 4 objektivave strategjike, CiviKos në bashkëpunim me ZQM kanë organizuar konsultim publik nëpër të gjitha regjionet e Kosovës gjatë muajve Gusht-Tetor.

Përzgjedhja e anëtarëve të shoqërisë civile në trupa të ndryshëm publik

Qeveria e Kosovës ka vazhduar të shfrytëzojë mekanizmin që CiviKos ofron për përzgjedhjen e anëtarëve të shoqërisë civile në trupa të ndryshëm publik. Me kërkesë të Ministrisë së Financave CiviKos ka organizuar procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të shoqërisë civile për hartimin e një akti nënligjorë për përcaktimin e “Kritereve dhe Procedurave të Financimit të Personave Fizik dhe Juridik (përveç OJQ-ve), bazuar në nenin 53 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë”.

Me kërkesë të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, CiviKos ka hapur thirrjen për përfaqësues të shoqërisë civile për hartimin “Udhëzimit Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna”.

Konsultime Regjionale me Organizata të shoqërisë civile në Kosovë

Gjatë muajit Maj Sekretariati i CiviKos ka realizuar një seri të takimeve konsultative me organizata të shoqërisë civile rreth aktiviteteve të fundit të CiviKos, si dhe zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile, si dhe përgatitjet për strategjinë e re.

Takimet janë organizuar në:



- **Mitrovicë** në bashkëpunim me organizatën Community Building Mitrovica - CBM, me datë 24 Maj 2018;

- **Gjilan** në bashkëpunim me organizatën NOPM me datë 30.05.2018;

- **Ferizaj** në bashkëpunim me organizatën INPO me datë 30.05.2018;

- **Prizren** në bashkëpunim me organizatën Ec ma Ndryshe me datë 29.05.2018;

- **Pejë** në bashkëpunim me organizatën

Syri i Vizionit me datë 28.05.2018.

Të gjitha këto takime janë organizuar në kuadër të projektit të mbështetur nga DSP.

Vlerësimi shtetëror rreth parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Angazhimi i CiviKos

CiviKos duke qenë pjesë e grupit punues për vlerësimin shtetëror për parandalim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ka avokuar që masat e propozuara që e ndikojnë punën e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë të jenë në linjë me parimet e përgjithshme të së drejtës për liri të asociimit, pa kufizime që eventualisht do të pengojnë punën e shoqërisë civile në Kosovë. CiviKos ka lehtësuar takimet e disa organizatave të shoqërisë civile për të adresuar disa nga masat e draftit të parë të raportit të vlerësimit të rrezikut për pastrimin e parave, dhe parandalimin e financimit të terrorizmit, të cilat masa janë identifikuar si problematike për punën e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë.

Disa nga aktivitetet e mbajtura janë:

- 19.04.2018- Në zyrat e CiviKos është mbajtur takim pune me përfaqësues të KCSF, BIRN, GLPS, KCSS, ATRC, KIPRED, KLI dhe GAP për të diskutuar të gjeturat e vlerësimit. Në takim janë identifikuar disa nga pikat problematike, ku janë përgatitur komente dhe sugjerime me shkrim të cilat përmes CiviKos janë adresuar në grupin punues.
- 24.04.2018- CiviKos ka dorëzuar komentet e shoqërisë civile sa i përket ndryshimeve të propozuara në masat e identifikuara si problematike për punën e OSHC-ve në Kosovë.
- 30.05.2018- Është mbajtur takimi i fundit i grupit punues ku të gjitha komentet/rekomandimet e shoqërisë civile janë aprovuar nga grupi punues.

Problemi i OJQ-ve me Bankat Komerciale



Organizatave të shoqërisë civile në Kosovë tash e një kohë po ballafaqohen me probleme të ndryshme me bankat komerciale. Vështirësitë në hapje të llogarive bankare, mbyllja e tyre pa paralajmërim, bllokimi i llogarive etj, janë disa nga problemet që OJQ-të po ballafaqohen në përgjithësi.

CiviKos ka përgatitur një pyetësor të shkurtër i cili u është ndarë organizatave të shoqërisë civile për të parë se cilat janë problemet me të cilat ato janë ballafaquar kohëve të fundit me bankat komerciale. Këto të dhëna na kanë ndihmuar të kemi një pasqyrë më të qartë të natyrës së problemeve në mënyrë që të avokojmë tek institucionet përgjegjëse për t'i qartësuar dhe eliminuar këto probleme. Ne kuadër të këtij aktiviteti

Civikos së bashku me përfaqësues të organizatave IKS, KIPRED, INDEP, GAP dhe në bashkëpunim me Zyrën Për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit takuan përfaqësuesit e Bankës Qendrore, dhe Njësisë për Inteligjencë Financiare, ku u diskutuan problemet që OJQ-të po ballafaqohen me bankat komerciale në Kosovë.

Përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse kanë rekomanduar që të përgatitet një analizë më e detajuar sa i përket problemit me bankat komerciale. Ligji i ri për Liri të Asocimit i cili është ende në Kuvend adreson çështjen e hapjes dhe mirëmbajtjes së llogarive bankare. Aprovimi i këtij ligji do të ishte një moment i mirë për të avokuar tek Banka Qendrore në adresim të çështjes së problemeve me bankat komerciale.

Grupet punuese të CiviKos - Pjesëmarrja në procesin e konsultimit publik

Në kuadër të projektit financuar nga MATRA, CiviKos ka hapur thirrjen për formimin e dy grupeve punuese për monitorimin e procesit të konsultimit publik që qeveria organizon me shoqërinë civile dhe palet tjera.

Grupi i parë punues ka monitoruar aktet nënligjore për:

- Tatimin në Pronën e Paluajtshme, në kuadër të Ministrisë së Financave;
- Projekt-Udhëzimi Administrativ për Kategoritë e Vlerave Metodave dhe Modelet e Vlerësimit;
- Projekt-Udhëzimin Administrativ për Regjistrat e Tatimit në Pronë, Përgjegjësitë dhe Procedurat për Menaxhimin e Informacionit;
- Projekt Rregulloren për Strukturën Organizative të njësive për Administrativin e Tatimit në Pronë në Komuna dhe Parimet e Administrimit Tatimor;
- Projekt Rregulloren për Përgjegjësitë;
- Procedurat e Funkionimit dhe mënyrën e kompensimit të Kryetarit dhe Anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme;
- Projekt Udhëzimin për Shtyrjen e Afatit për Pagesën e Detyrimeve;
- Projekt Udhëzimin për Procedurat Ankimore;
- Projekt Udhëzimin për Shërbime Komunale që Pezullohen për Mbledhjen e Detyrimeve Tatimore të Papaguara, dhe;
- Projekt Udhëzimin për Procedurat e Komunikimit ndërmjet Autoriteteve Publike, Personave Juridik ose Organeve që kanë në Administrim ose disponojnë informacionin e nevojshëm për Administrimin e duhur të Procesit të Tatimit në Pronë.

Grupi i dytë punues ka monitoruar:

- Ligjet e Reformës së Administratës Publike;
- Projektligjin për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencie të Pavarura;
- Projektligjin për Zyrtarët publik dhe Projektligjin për pagat.

BASHKËPUNIMI PLATFORMA CIVIKOS - SHOQËRI CIVILE

Lansimi i fushatës “Pjesëmarrja Qytetare në Procesin e Politikë-Bërjes”

Platforma CiviKos, me përkrahje të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë, gjatë muajit Maj ka lansuar fushatën “Pjesëmarrja Qytetare në Procesin e Politikë-Bërjes”. Pas serisë së punëtorive të organizuara në tërë Kosovën me temë “Pjesëmarrja Publike në Procesin e Konsultimeve Publike”, në koordinim me Qendrat Rajonale të CiviKos-it, Platforma CiviKos ka lansuar fushatën që kishte për qëllim të rris pjesëmarrjen qytetare në procesin e vendimmarrjes, përmes pjesëmarrjes në procesin e konsultimit publik.

Publikimi i raportit të monitorimit “Konsultimi publik me organizata anëtare të CiviKos gjatë vitit 2017”

Me datë 11.06.2018 Platforma CiviKos ka publikuar raportin përmbledhës “Konsultimi Publik me Organizata Anëtare të Platformës CiviKos gjatë vitit 2017”.

Për të identifikuar dhe matur pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në procesin e konsultimit publik, Sekretariati i CiviKos qysh nga viti 2013 realizon çdo vit hulumtim me organizatat anëtare, dhe jo anëtare përmes pyetësorëve online dhe intervistave individuale me organizatat e shoqërisë civile aktive në procesin e konsultimit publik. Nga viti 2014 CiviKos çdo vit publikon raportet rreth pjesëmarrjes së shoqërisë civile në procesin e konsultimit publik.

Raporti i monitorimit për vitin 2017 është përgatitur me mbështetje të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë.

Raportin e plotë mund ta gjeni këtu :

http://www.civikos.net/repository/docs/2017_Konsultimet_me_organizatat_anetare_548465.pdf



Trajnimet në kuadër të projektit TEAM të USAID

Në muajin Prill Platforma CiviKos ka realizuar edhe trajnimin e fundit në kuadër të serisë së trajnimeve “**Bashkëpunimi në mes Mediave dhe Shoqërisë Civile në Adresim të Korrupsionit**” në qytetin e Mitrovicës së Veriut me datë 11-13 Prill, trajnimi është organizuar nga CiviKos në kuadër të projektit të USAID Komuna Transparente Efektive dhe Llogaridhënëse TEAM. Ky trajnim ka



ofruar mundësi për vazhdimin e përfitimit të njohurive rreth prokurimit publik me fokus në adresimin e korrupsionit. Në kuadër të projektit TEAM janë organizuar trajnime në 7 regjione të Kosovës për organizatat e shoqërisë civile.

Nga Shtatori CiviKos ka vazhduar me ngritjen e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile në monitorim të prokurimit publik përmes trajnimeve në zyre të organizatave antare.

Organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në nivel lokal (Rajoni i Ferizajit, Gjilanit, Mitrovica dhe Prishtina) kishin mundësi të mësojnë ciklin e monitorimit të prokurimit publik duke e monitoruar një kontratë reale.

Punëtoritë tani më janë mbajtur në rajonin e Gjilanit, Mitrovicës, Ferizajit dhe Prishtinës. Në vazhdim do të përfshihen të gjitha qytetet e tjera të Kosovës, ku organizatat që punojnë në monitorim të prokurimit publik do të kenë mundësi të përfitojnë nga këto punëtori që bazohen në metoda të aplikueshme në realitet.

Trajnimet në kuadër të projektit “Drejt një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në hartimin e politikave” përkrahur nga Ambasada Holandeze në Kosovë

Në Prill 2018 Platforma CiviKos ka organizuar edhe punëtorinë e fundit “Pjesëmarrja Publike në Procesin e Konsultimit Publik” për OSHC-të nga rajoni i Prishtinës (Fushë-Kosovë, Obiliq dhe Podujevë).

Organizatave pjesëmarrëse kanë qenë të gjitha organizatat që punojnë në fushën e politikë-bërjes, transparencës, llogaridhënies dhe evokimit. Punëtorija është mbajtur me 18 Prill 2018 në zyrat e Platformës CiviKos.



Punëtori rreth kontraktimit të shërbimeve për OSHC

CiviKos në bashkëpunim me European Centre for Non Profit Law (ECNL) me 24 Korrik 2018 në Orion ka organizuar punëtori gjysmë ditore me organizata të shoqërisë civile rreth kontraktimit të shërbimeve për OSHC. Qëllimi i punëtorisë ishte njoftimi me praktikën evropiane sa i përket kontraktimit të shërbimeve për OSHC. Rekomandimet e punëtorisë do të kontribuojnë përcaktimit të masave të reja në Strategjinë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2018-2022.



Punëtori me Organizata të Shoqërisë Civile - Vlerësimi Shtetëror i Kosovës Rreth Parandalimit të Financimit të Terrorizmit dhe Shpërlarjes së Parave

Platforma Civikos në bashkëpunim me European Centre for Non Profit Law (ECNL), me 13 Qershor 2018 në ORION ka organizuar punëtori me organizata të shoqërisë civile për të kuptuar më shumë rreth vlerësimit shtetëror që Kosova do të kalojë sa i përket parandalimit të financimit të terrorizmit dhe shpërlarjes së parave, dhe si ky proces e ndikon punën e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë.

Me datë 26 Qershor 2018 Drejtori i CiviKos Dardan Kryeziu me disa organizata të shoqërisë civile merr pjesë në takim

konsultativ që Këshilli Evropës ka organizuar sa i përket vlerësimit shtetëror të Kosovës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

